

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**, Departamenti Pergjithshem- Divizioni Civil, gjyqtari Bekim Salihu, me bashkepuntoren profesionale Fitore Hasani-Ismaili, në çështjen juridike-kontestimore sipas padisë së paditësit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], Komuna e Ferizajt, kundër të paditurit [REDACTED] nga Ferizaj rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. [REDACTED] nga Ferizaj, në çështjen juridike kompensim dëmi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 18.10.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], Komuna e Ferizajt dhe **OBLIGOHET** i padituri [REDACTED] nga Ferizaj rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] që paditësit në emër kompensimit të dëmit të t'ia paguaj shumat si vijojnë:

**1. në emër të dëmit jomaterial:**

- për shkak të dhimbjeve fizike të përjetuara shumën prej 2000€,
- për frikën e përjetuar shumën prej 1800.00 €,
- për dëmtime estetike dhe deformim i konkave të hundës shumën prej 3000€

**2. në emër të dëmit material:**

- për shpenzimet e shërbimeve të mjekimit shumën prej 500€, e që shuma e përgjithshme e shpërblimit i bie **7.300€ (shtatë mijë e treqind)**, të cilën shumë i padituri është obliguar t'ia paguaj paditësit, së bashku me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedurës në shumë prej **770.50€**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishëmrisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

**II. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit përtej vlerave të aprovuara dhe atë për friken e pësuar shumën prej 700€, për pagjumësi dhe ankth shumën prej 1.500€, shpenzimet e mjekimit shumën prej 300 €, shpenzime tjera shumën prej 500€, për shqetësime dhe trauma psikike shumën prej 1.000€, për trajtim në vazhdim të sinusit të dëmtuar shumën prej 5.000€, për trauma psikike gjatë intervenimit (tri herë) shumën prej 2.000 € dhe për pengesë për mosshfrytëzimin e pushimit vjetor shumën prej 1.000€, si e pabazuar.

## Arsyetimi

Paditësi në fjalën e tij ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë ashtu që gjykata ta aprovoj në tërësi kërkesë padinë si të bazuar ku është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë dhe se lëndimet trupore u vërtetuan nga ekspertizat mjeksore se nga ky incident unë kam pësuar lëndim të rëndë trupore dhe kam pengesa të përhershme në frymarrje për shkak të thyerjes së kockës së hundës të cilat fakte u administruan në shqyrtim gjyqësor. Gjithashtu i kërkoj shpenzimet e procedurës gjyqësore

Përfaqësuesi i përkohshëm të paditurit, në fjalën e tij ka deklaruar se mbetëm në tërësi pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar lartësinë e kërkesëpadisë pasi që mendimet e ekspertëve nuk përkoinjë me shumat e pretenduara pasi që janë tepër të larta dhe nuk i shërbejnë qëllimit të shpërblimit të pretenduar. Gjithashtu kërkoj shpenzimet e procedurës si përfaqësues i përkohshëm.

Gjykata për ta vërtetuar drejt gjendjen e fakteve ka bërë administrimin e provave: *parashtrësia e paditësit drejtuar Gjykatës së Apelit me shënim PA 1.nr. 8/16 , plotësimi i ekspertizës të hartuar në procedurë penale nga eksperti mjeko- ligjorë Dr. [REDACTED] e hartuar me 11.06.2014 , raporti mjekësor nga QKUK Prishtinë me numër 23415 i datës 27.07.2012, raporti specialistik ambulator nga ordianca neuro kirurgjia e datës 07.08.2012 , 08.09.2012 , raporti i Qendrës Spitalore ne Prishtinë me nr. 1065 i datës 11.02.2013, raporti konsulent në QKUK me nr. 5991 i datës 16.09.2015 ,raporti nga Qendra Emergjente në Ferizaj i datës 26.07.2012 me numër 546 me (2 foto pa ngjyre), raporti nga QKUK Instituti i Radiologjis i dt. 27.07.2012, raporti laboratorik me nr. 461 i dt.03.08.2012, aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Ferizaj P.nr.1140/12 i datës 14.08.2014, aktgjykimi i Gjykates së Apelit me shenjen PAI nr.78/16 i dt.18.04.2016, fletlëshimi nga QKUK Klinika e otorinolaringologjisë me nr.2381/849 i dt. 14.12.2015, u shiquan (2 foto me ngjyra ne zarf), ekspertiza e ekspertit psikiatër e datës 28.09.2018 dhe , ekspertiza e ekspertit nga ORL e dt. 09.10.2018.*

Gjykata, pas shqyrtimit dhe analizimit që u bëri provave veç e veç dhe të ndërlidhura reciprokisht ne mes veti, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata në këtë çështje juridike, si kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse ka gjetur faktet lidhur me përcaktimin lartësisë së shumave të pretenduara nga paditësi përkitazi me lëndimet e pësuar nga i padituri.

Gjykata, në këtë procedurë ka gjetur se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se i padituri kishte shkaktuar lëndim paditësit , pasi që kjo u vërtetua me aktgjykimin penal P.nr. 1140/12 i datës 14.08.2014, me të cilin aktgjykim i padituri ka pranuar fajësinë për lëndim e shkaktuar ndaj paditësit, andaj gjykata nuk ka dhënë vlerësimet e saja, posaçërisht, lidhur me bazën juridike të përgjegjësisë civilo-juridike të paditurit sepse është e qartë se paditësi si pasojë

e veprimeve të paligjshme të të paditurit, ka pësuar lëndime të renda trupore të konstatuara edhe në ekspertizat mjekësore të psikiatrisë dhe të otolaringologjisë.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të pretendimeve lidhur me shkallën, natyrën, intenzitetin, kohëzgjatjen dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi, me propozimin e paditësit, ka bërë marrjen e provës përmes ekspertimit nga eksperti i lëmisë së otolaringologjisë dhe psikiatrisë.

Mbi bazën e mendimeve dhe konstatimeve profesionale, që kanë dhënë drejtpërdrejtë në seancën e datës 18.10.2018 dhe në ekspertizat e tyre të punuara me shkrim nga ekseptret Dr. ■■■■■ otorinolaringolog dhe Dr. ■■■■■ psikiatër, është vërtetuar se te paditësi, si pasojë e goditjeve të marra nga i padituri më datë 26.07.2012, paditësi ka marrë lëndimet trupore, të diagnostifikuara si:

- frakturë multifragmentare me dislokim të fragmenteve të kockave nazale,
- frakture suspekto e murit të sipërm të orbitës së majtë,
- frakturë e septmit (ndarëses) të hundës,
- lëndim lacero-kontuziv i tërë trashësisë së lëkurës.

Lëndimet e tilla janë kualifikuar (sqaruar) nga eksperti në seancën e datës 18.10.2018, si lëndime të **rënda trupore**, që tek paditësi kanë shkaktuar dëmtim të përhershëm të shëndetit e që për pasojë tek paditësi ka rezultuar dëmtim të hundës me pasoja të përjetëshme të cilat nuk mund të shërohen dhe korrelojnë me shfaqjen edhe të sëmundjeve të tjera në aspektin psikik dhe kardiovaskular. Edhe përkundër intervenimit kirurgjik në zgavrën e hundës vërehen deformitete, të cilat janë si pasojë e dëmtimit të mukozës së hundës nga lëndimi i shkaktuar. Ndryshimet e tilla ndikojnë në kalueshmërinë e ajrit në hundë, ku pacienti merr frymë vetëm me gojë ku si pasojë e kësaj bënë gjumë të parehatshëm dhe gërhet në gjumë.

Eksperti i psikiatrisë, ka konstatuar se tek paditësi, në momentin e incidentit është manifestuar frikë primare të intenzitetit të lartë që ka zgjatë 3 javë, të intenzitetit të mesëm për 4 javë, dhe të ultë për 6 javë. Frika e intenzitetit të lartë është manifestuar si rezultat i gjakderdhjes së vazhdueshme nga hunda, rikujtimi i shpeshtë i ngjarjes, anktheve gjatë natës si dhe ëndërrave të këqija.

Frika e intenzitetit të mesëm është manifestuar si shkak i shqetësimit për pasojat e mundëshme nga lëndimi, pengesa në gjumë, ankthe të kohëpaskohëshme rikujtime të incidentit si dhe pasiguri për të dalë në ambiente të hapura. Frika e intenzitetit të ulët është manifestuar me të njëjta simptoma por me intezitet më të ulët.

Gjykata shumëmb përtej vlerave të aprovuara e refuzoi si të pabazë kërkesat e paditësit për arsye se paditësi thënie e tij si në pikën 5 dhe 6 (për shpenzime mjekësore dhe shpenzime tjera) të padisë nuk i ka mbështetur ne prova (faktura) për shpenzimet gjatë shërimit, ndërsa pikën 3 (për pagjumësi dhe ankth gjatë gjumit mandej pikën 7 (për shqetësim dhe traum psikike), pikën

vazhdim të sinusit të dëmtuar), pikën 9(për trauma psikike gjatë intervenimit kirurgjik) dhe pikën 10(për pengesë në shfrytëzimin e pushimit vjetor), këto kategori nuk janë paraparë me asnjë dispozit ligjore nga LMD-ja si forma të veçanta të kompensimit të dëmit andaj gjykata i refuzoi si të pabazuara.

Gjykata, për të gjitha këto forma të dëmit jomaterial, paditësit i ka gjykuar shumat si në dispozitiv, duke u bazuar edhe në bindjen e saj të lirë, të krijuar nga procesi i gjithmbarshëm i këtij shqyrtimi gjyqësor dhe praktikes gjyqësore, me synim se vlerat e gjykuara paditësit kurrë nuk do të mund t`ia rikuperonin gjendjen shëndetësore që kishte para incidentit, por se atij ky zhdentim do t`i shërben si satisfaksion moral, për të mirat që ka humbur në dëmtimin e shëndetit të tij dhe kjo pagesë tek ai do te ketë sado pak ndikim pozitiv në këndelljen e shëndetit të tij, duke krijuar tek ai ndjenjën e besimin, për t`iu qasur rrjedhave të zakonshme të jetës normale.

Gjykata, shumat e aprovuara i ka gjykuar paditësit bazuar në nenin 323 te LPK-së dhe nenit 173 dhe 183 par.1 lidhur me nein 179 të LMD-se, në emër të shpërblimit i cili në këtë rast nuk ka qëllimin e rikthimit të të mirës së dëmtuar tek paditësi, por se ka për qëllim rivendosjen e ekuilibrit të ç`rregulluar në gjendjen shpirtërore të paditësit, duke i dhënë atij një satisfaksion moral, se dikush është gjetur fajtor për dëmtimin e shëndetit të tij, për këtë gjë i është detyruar atij me këtë formë të "shpërblimit të dëmit të plote".

Gjykata lidhur me kamatën e llogaritur ka vendosur bazuar në nenin 278 lidhur me nenin 382 te LMD-së.

Meqenëse paditësi ka patur sukses në pjesën e konsiderueshme të pretendimeve të tij, gjykata në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, ka obliguar të paditurën që t`ia kompensoj shumën prej 770.50€ dhe për dy seanca të mbajtura për përfaqësuesin e përkohshëm shumën prej 374.00€, për përgjigje në padi shumën prej 104 euro, për rimbussimin e shpenzimeve për shërbimet e ekspertëve shumën prej 200€ si dhe taksën gjyqësore për padi në shumë prej 96.50€.

### GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.149/17 me 18.10.2018

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROSEVAC

Më  
Dana 12.02.2019



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në gjykatën e Apelit ne Prishtinë, përmes kësaj gjykate.



Gjyqtari,  
Bekim Salihu